



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 2286 Prot.

Tiranë, më 23.07.2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1331/1 PROT., DATË 11.06.2026 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR
TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. LUAN MILLA”**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Luan Milla me nr. 1178 prot., datë 02.05.2024, në të cilën ngrihen pretendime për veprimtarinë hetimore dhe gjyqësore të magjistratëve G.H., dhe M.M., me detyrë gjyqtar dhe prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për një vepër penale, për të cilën pretendon se nuk e ka kryer dhe me vendimin nr. 1331/1 prot., datë 11.06.2026, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Luan Milla”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e saj. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke qenë se adresa e tij rezulton sipas fletëlirimit të Drejtorisë së Burgjeve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

